

Ford

TOURNEO CUSTOM



**VIZIONAR. GJENIAL. MBRESËLËNËS.
ÇDO AUTOMJET MBAN FIRMËN E TIJ.**

Henry Ford



Tregohet "Tourneo Custom Titanium L1" me disqe aliazhi 17" 10-shkallëshe në "Dark Tarnish" (opsion), në ngjyrë cilësore trupi "Grey Matter" (opsion).



Tregohet "Tourneo Custom Titanium L2" me kamerë për shikim pas (opsion), në ngjyrë metalike trupi "Orange Glow" (opsion).

PËRMBAJTJA

Seria "Active"	2	Trend	26
Pjesa e brendshme	4	Titanium	28
Dizajni inteligjent	10	Titanium X	30
Audioja dhe komunikimi	12	Active	32
FordPass Connect	13	Sport	34
Teknologjia e ndihmës për shoferin	14	Zbukurimet e brendshme	36
Ndriçimi i jashtëm	18	Ngjyrat e trupit	38
Motorët	20	Disqet	39
Teknologji që ju lehtëson jetën	22	Pjesët shtesë	40
		Opsionet e veçanta të automjetit	42
		Specifikimet	44



Tourneo Custom Active

Zbuloni "Tourneo Custom Active" të ri aventuresk. Me stilin e tij të fortë për rrugë të vështira, teknologjitë e përparura dhe pjesën e brendshme komode dhe të qëndrueshme, është gati t'ju ndihmojë të përballoni edhe ditën më të vështirë. Bazuar në serinë "Titanium", vjen me disqe të veçanta aliazi 17", grilë të përparme unike "Active" dhe veshje trupi, shina çatie me shkëlqim dhe shkallë anësore me gjatësi të plotë. Karakteristikat e brendshme përfshijnë zbulime të veçanta të sediljeve në "Nordic Blue" dhe për kapacitetet shtesë në kushte më të vështira, modelet me transmision manual disponohen me një diferencial opsional mekanik me rrëshqitje të kufizuar.



Diferenciali mekanik me rrëshqitje të kufizuar

Diferenciali mekanik me rrëshqitje të kufizuar i "Tourneo Custom" mund të ndihmojë në reduktimin e xhirimit të padëshiruar të rrotave, veçanërisht në sipërfaqe të lira. Duke drejtuar automatikisht forcën e rrotullimit te rrotat me forcë më të madhe kapjeje, ai përmirëson kapacitetin e drejtimit me rrota të përparme aktive të "Tourneo Custom" dhe ofron nivele më të mëdha fërkimi, qëndrueshmërie dhe qetësie në kushte më sfiduese. (Opsion në të gjitha seritë me transmision manual)

Tregohet "Tourneo Custom L1 Active" me disqe aliazi 17" 5-shkallëshe (standard), në ngjyrë metalike trupi "Orange Glow" (opsion).



Zini vend në klasin e parë

"Ford Tourneo Custom" shkëlqen kur bëhet fjalë për komoditet dhe mirëqenie. Duke kombinuar stilin dhe cilësinë e një salloni luksoz me praktikitetin dhe hapësirën e brendshme të një automjeti për pasagjerë, ai ofron vend për deri në nëntë pasagjerë. Gama e pasur e veçorive dhe pajisjeve të mirëmenduara siguron nivele akoma më të larta rafinimi. Sedilja e shoferit dhe kolona e timonit janë plotësisht të rregullueshme për t'ju ndihmuar të gjeni pozicionin ideal të drejtimit. Në të njëjtën kohë, pasagjerët mund të relaksohen me opsione si kondicioneri në pjesën e pasme, mbështetëset e përkulshme të sediljeve dhe zbukurimet luksoze të sediljeve prej lëkure.

Suspension i pasmë me ajër

Rregullohet automatikisht për të ruajtur një lartësi konstante drejtimi, pavarësisht kushteve të ngarkesës, për drejtim më të qetë dhe më komod. (Opsion në "Trend" dhe "Titanium")





Tregohet "Tourneo Custom Titanium" me zbulurime lëkure "Salerno" në "Palazzo Grey" (opsion).

Hapësirë për të gjithë

Me strukturën e sediljeve në stil salle konferencash, pjesa e brendshme e bollshme e "Tourneo Custom" është po aq fleksibël sa edhe komode.

Disponohen dy versione: Sedilje universale në stil salle konferencash (standard në "Trend"), me sedilje individuale në rreshtin e dytë dhe sedilje 2+1 në rreshtin e tretë; dhe sedilje tejet universale në stil salle konferencash (standard në "Titanium", "Titanium X" dhe "Sport") ku ofrohen sedilje individuale në rreshtin e dytë dhe të tretë për nivel maksimal praktikiteti.

Sediljet individuale të rreshtit të dytë mund të rrotullohen për t'u kthyer përpara ose prapa dhe të gjitha sediljet mund të palosen, të ulen, të fshihen ose të hiqen sipas kërkesave të udhëtimit.

Zgjidhni midis L1 që ofron hapësirë të bollshme për deri në nëntë persona, L2 me hapësirë më të madhe prapa për bagazhet; ose "Tourneo Custom L2" në version autobus me sedilje me hyrje të drejtpërdrejtë. Cilido qoftë modeli juaj i preferuar, do të zbuloni se pjesa e brendshme e rregullueshme mund të personalizohet lehtësisht për të përbushur nevojat tuaja familjare apo të punës.

"Tourneo Custom" në version autobus

Me komoditetin e pasagjerëve në fokus, "Tourneo Custom L2" në version autobus ofron hapësirë të bollshme në secilin prej katër rreshtave të sediljeve me hyrje të drejtpërdrejtë. Sediljet e pasme arrihen lehtë nga dera anësore me rrëshqitje. Të disponueshme në të gjitha seritë, së bashku me një opsion zbulurimi të plotë me lëkurë, kjo është mënyra ideale për të vënë komoditetin e pasagjerëve dhe lëvizshmërinë përpara hapësirës së bagazheve.



Tourneo Custom L1

Tourneo Custom L2



"Tourneo Custom L1" me 9 sedilje



"Tourneo Custom L2" me 9 sedilje



"Tourneo Custom L2" në version autobus me 9 sedilje

Vini re: Një sedilje fëmije që sheh nga pas nuk duhet vendosur në rreshtin e dytë të sediljeve kur ky i fundit sheh prapa në drejtim të rreshtit të tretë.



Më shumë hapësirë, më pak mundim

Rehatoni deri në nëntë persona në komoditet të cilësisë së lartë. Palosni mbështetëset e sediljeve për të krijuar një hapësirë të rrafshët pune. Ose rrotulloni, palosni, ulni ose fshihni sediljet e pasme në disa mënyra për të krijuar hapësirë si në limuzinë ose për të maksimizuar hapësirën e bagazheve, pa lënë sedilje pas.

Në momentin e dorëzimit, sediljet janë organizuar në stil salle konferencash, pra rreshtat e sediljeve të pasme janë përballë njëri-tjetrit për të lehtësuar bashkëbisedimin ndërmjet pasagjerëve. Megjithatë, sediljet e pasme mund të riorganizohen lehtësisht sipas dëshirës së gjithsecilit.

Nëse ju nevojitet më shumë hapësirë, sediljet e pasme mund të hiqen tërësisht, qoftë veç e veç, qoftë në grupe, për të krijuar një hapësirë të madhe dhe praktike për çdolloj gjëje që dëshironi të transportoni.

Vini re: Një sedilje fëmije që sheh nga pas nuk duhet vendosur në rreshtin e dytë të sediljeve kur ky i fundit sheh prapa në drejtim të rreshtit të tretë.



Figura kryesore (majtas): Tregohet "Tourneo Custom Titanium" me zbukurime lëkure "Salerno" në "Dark Palazzo Grey" (opcion) në konfigurim sediljesh në stil salle konferencash.

Vini re Seria "Trend" ka rresht të tretë sediljesh 2+1, në vend të sediljeve individuale.

FORD TOURNEO CUSTOM Dizajn inteligjent



Plot me hapësirë

Me hapësirën e brendshme të bollshme dhe një strukturë të rregullueshme sediljesh, "Tourneo Custom" është gjithmonë gati t'ju akomodojë juve, pasagjerët tuaj dhe sendet tuaja personale.



Kamerë për shikim pas me ndihmë për tërheqjen e rimorkios

Zgjidhni marshin e lëvizjes pas dhe pamja nga kamera për shikim pas shfaqet automatikisht. Vijat shënjuese që mbivendosen në pamjen e kamerës tregojnë se ku po shkon automjeti. (Standard në Titanium X, opion në seritë e tjera) Shënim: Kamerat funksionojnë vetëm në shpejtësi nën 10 km/orë (6 mph).

Zgjidhje novatore magazinimi

Opsionet funksionale të magazinimit përfshijnë mbajtëse gotash dhe një hapësirë magazinimi të fshehur poshtë një kapaku të këndshëm me rul, xhepa të mëdhenj në dyert e përparme dhe një kruskot me kyçje. (Standard)



Sedilje elektrike dhe me ngrohje për shoferin

Me 10 pozicione rregullimi të sediljes me ngrohje të shoferit, mund ta gjeni me lehtësi pozicionin më të rehatshëm të drejtimit. (Standard në "Titanium X", "Active" dhe "Sport", opion në "Titanium")

Transmision automatik "SelectShift"

"Tourneo Custom" mund të specifikohet me një transmision automatik "SelectShift" me 6 marshe. Transmisioni ofron gjithashtu opionin e ndërrimit manual të marsheve me anë të butonave në levën e marsheve. (Opsion në modelet 130 PS, 150 PS dhe 170 PS)



Dyer me rrëshqitje dhe shkallë anësore

Shkallët anësore të montuara poshtë dyerve anësore me rrëshqitje e bëjnë hyrjen dhe daljen akoma më të lehtë, ndërkohë që përmirësojnë stilin luksoz të "Tourneo Custom". (Standard në "Trend", "Titanium" dhe "Titanium X")



Skarë e integruar në çati

Një sistem gjenial skare në çati që paloset plotësisht kur nuk përdoret, me qëllim që të përmirësojë kursimin e karburantit dhe të reduktojë zhurmën e ajrit, në krahasim me skarat tradicionale të çatisë. Me kapacitet transportimi ngarkesash deri në 130 kg, skara në çati ka një bllokues ngarkese dhe fole të integruara në formë T-je, të cilat përputhen me pjesët shtesë standarde të skarës në çati për të maksimizuar funksionalitetin e saj. (Opsion. Ka kufizime.)



Pika fiksimi "ISOFIX" për sediljen e fëmijës

Për sigurinë e pasagjerëve, në disa sedilje të rreshtit të dytë dhe të tretë janë vendosur në total katër pika fiksimi "ISOFIX" për sediljen e fëmijës. (Standard. Pozicioni varet nga seria)

Vini re: Një sedilje fëmije që sheh nga pas nuk duhet vendosur në rreshtin e dytë të sediljeve kur ky i fundit sheh prapa në drejtim të rreshtit të tretë.

Konvertues rryme 230 V (150 W)

Përdorni ose karikoni pajisjet tuaja të preferuara pa nevojën e përshtatësve të posaçëm. Thjesht futini në prizë siç do bënit në shtëpi. (Opsion)



Xham i errësuar dhe perde në dritaret e pasme

Mbrojtëset e integruara kundër diellit mund të ngrihen lehtësisht për t'i mbrojtur pasagjerët prapa nga ndriçimi i diellit. Xhami i errësuar shton një nivel tjetër privatësie dhe sofistikimi. (Standard në "Titanium", "Titanium X", "Active" dhe "Sport")





Njihuni me mikun e ri më të mirë të telefonit tuaj

100% i lidhur



"Ford SYNC 3"

"Ford SYNC 3" i disponueshëm integrohet më së miri me celularin tuaj inteligjent, duke ju mundësuar të kontrolloni gjithçka, nga telefonatat dhe mesazhet me tekst deri te muzika dhe navigimi satelitor – të gjitha përmes ekranit qendror me prekje ose përmes komandave tejet të thjeshta zanore. Përditësimet e hartës ju ndihmojnë të ruani drejtimin e duhur dhe të jeni në kohë dhe ofrohen falas për një periudhë të kufizuar pas regjistrimit të automjetit.

Në SYNC 3 përfshihet*

- Menaxhimi i telefonit, muzikës, aplikacioneve dhe navigimit me komanda të thjeshta zanore
- Leximi me zë i mesazheve me tekst për ju
- Ndihma e emergjencës¹ ndihmon pasagjerët të bëjnë një telefonatë emergjence për t'u dhënë shërbimeve të emergjencës informacion mbi vendndodhjen e automjetit në gjuhën përkatëse
- Kontrolli me "AppLink" i aplikacioneve të përputhshme me SYNC, ndërsa "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" mundësojnë navigimin në celularin inteligjent përmes ekranit kryesor të SYNC 3, si të ishte receptori i telefonit
- Ekranin me prekje dhe me ngjyra mbështet lëvizjet me shumë prekje "rrëshqit" dhe "afro gishtat për të zmadhuar", si dhe ju lejon të organizoni ikonat e aplikacioneve dhe afishimet në sfond siç do të vepronit në tabletin ose celularin tuaj inteligjent

- "Live Traffic"**^{***} Dërgon informacion të përditësuar për trafikun drejtpërdrejt në sistemin e navigimit SYNC 3. Më pas, teknologjia rregullon itinerarin e rekomanduar bazuar në gjendjen e trafikut, në mënyrë që të mos humbisni kohë gjatë rrugës drejt punës tjetër
- Informacioni lokal për rreziqet**^{***} Përdor burime të shumta vendore dhe kombëtare për t'ju paralajmëruar për rreziqet në rrugën përpara

*Mos e drejtoni automjetin kur jeni të shpërqendruar. Përdorni sisteme operimi zanore kur është e mundur; mos përdorni pajisje dore gjatë drejtimit të automjetit. Disa veçori mund të bllokohen kur automjeti është në marsh. Jo të gjitha veçoritë janë të përputhshme me të gjithë telefonat.

Vini re: Integrimi i plotë i celularit inteligjent me "SYNC 3" disponohet vetëm me "iPhone 5/Android 5.0 (Lollipop)" e lart. Për disa funksione të "SYNC 3" kërkohet lidhje të dhënash, ndaj do të aplikohen tarifa për të dhënat celulare. Për të verifikuar disponueshmërinë e "Apple CarPlay" dhe "Android Auto" në tregun tuaj, kontrolloni faqet e tyre zyrtare të internetit për informacionet më të reja.

¹Ndihma e emergjencës e "Ford" është një veçori novatore e SYNC që përdor celularin e çiftuar dhe të lidhur me "Bluetooth" për t'i ndihmuar pasagjerët të telefonojnë drejtpërdrejt qendrën lokale të komunikimeve në rast përplasjeje të automjetit që shkakton aktivizimin e një airbag-u ose fikjen e pompës së karburantit. Veçoria funksionon në mbi 40 rajone dhe shtete evropiane.

Vini re "FordPass Connect" mundëson shërbimet e lidhura dhe është i disponueshëm në automjetet e zgjedhura ose në automjetet me navigim. "FordPass Connect" do të aktivizohet në momentin e dërgimit të automjetit. Mund të zgjidhni nëse doni t'i ndani ose jo disa prej të dhënave. Shërbimi dhe mbulimi i të dhënave nuk disponohet kudo. Mund të zbatohen tarifa për të dhënat. Zbatohen politikat e privatisë të "FordPass" dhe "Connected Car", të cilat janë të disponueshme në faqen lokale të internetit të "Ford".

^{**}Live Traffic: "Live Traffic" është pa pagesë me "FordPass Connect" për 12 muajt e parë; më pas paguhet një tarifë abonimi.

^{***}LHI: Informacioni lokal për rreziqet është një shërbim me abonim me një periudhë prove pa pagesë prej një viti kur blini një "Ford" të ri.

Reagon përpara se ta kuptoni

Duke kombinuar informacionin nga kamera e drejtuar përpara dhe teknologjinë e radarit, "Tourneo Custom" mund të ndihmojë në situata të ndryshme drejtimi. Që nga ndihma para përplasjes (opsion) që mund t'ju sinjalizojë për një përplasje të mundshme e deri te ndihma inteligjente e shpejtësisë (opsion) që ju ndihmon të qëndroni brenda kufijve të afishuar të shpejtësisë, "Tourneo Custom" është pajisur më mirë se kurrë më parë për t'ju ndihmuar.



Ndihma para përplasjes⁽²⁾

Duke përdorur radarin dhe një kamerë, ndihma para përplasjes⁽²⁾ e mban nën vëzhgim rrugën përpara. Sistemi monitoron largësinë tuaj nga automjetet e tjera dhe këmbësorët – madje edhe në errësirë, kur ndriçohen nga fenerët e automjetit – dhe mund t'ju sinjalizojë për përplasje të mundshme. Nëse nuk reagoni ndaj sinjaleve paralajmëruese të sistemit, frenimi aktiv⁽²⁾ parangarkon sistemin e frenimit dhe mund të frenojë automatikisht për të ndihmuar në zbutjen e efekteve të përplasjes. (Opsion si pjesë e kontrollit përshtatës të drejtimit)

Kontrolli përshtatës i drejtimit⁽²⁾

Caktoni shpejtësinë që dëshironi dhe kontrolli përshtatës i drejtimit do ta ruajë distancën e paracaktuar nga automjeti përpara. Nëse sensorët diktojnë ngadalësim të trafikut përpara, automjeti juaj ngadalëson automatikisht. Kur nuk ka trafik, automjeti rrit sërish shpejtësinë derisa arrin shpejtësinë e paracaktuar. (Opsion)

Ndihma inteligjente e shpejtësisë⁽²⁾

Kur aktivizohet, sistemi e kufizon automatikisht shpejtësinë e automjetit në kufirin e diktuar⁽¹⁾ nga sistemi i njohjes së shenjave të qarkullimit. Përveç kufirit të diktuar të shpejtësisë, drejtuesi mund të zgjedhë edhe tolerancën e shpejtësisë maksimale. (Opsion, disponohet me kosto shtesë vetëm kur porositet edhe navigimi dhe kontrolli përshtatës inteligjent i drejtimit)



Sinjalizuesi i shoferit⁽²⁾

Projektuar për t'ju paralajmëruar në rast se sistemi zbulon sjellje në drejtim që tregon rënie të niveleve të vigjilencës. Fillimisht shfaqet një ikonë paralajmëruese në panelin e instrumenteve, e cila ndiqet nga një tingull paralajmërues në drejtim bie edhe më tepër. (Standard me paralajmërimin për ruajtjen e korsisë)

⁽²⁾Përdor sensorë. ⁽²⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.

Vini re Veçoritë e ndihmës për drejtuesin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e drejtuesit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin.

⁽¹⁾Kufiri i shpejtësisë mund të ndryshojë në varësi të rrugës dhe madhësisë së automjetit. Drejtuesi i mjetit mban përgjegjësi për respektimin e kufirit të shpejtësisë gjatë gjithë kohës.

Shënim Ndihma para përplasjes me frenim aktiv mund të diktojë këmbësorët, por jo në të gjitha kushtet, dhe nuk zëvendëson drejtimin e sigurt. Shihni manualin e zotëruesit për kufizimet e sistemit.





Dikton atë që ju s'mund ta shihni

"Tourneo Custom" shfrytëzon teknologjinë më të re që kujdeset për ju, automjetin tuaj dhe personat përreth. Një sistem i tillë është sinjalizuesi për trafikun në kryqëzim, i cili është projektuar për të ndihmuar gjatë daljes mbrapsht nga një vendparkim ku shikimi pengohet nga automjetet e parkuara në të dyja anët. Sistemi mund të japë paralajmërime akustike dhe vizuale për të ulur rrezikun e përplasjes me një automjet që po afrohet. (Opsion)



Sinjalizues për trafikun në kryqëzim⁽²⁾

Si pjesë e sistemit të informimit për pikat e vdekura të shikimit, sinjalizuesi për trafikun në kryqëzim kontrollon majtas dhe djathtas ndërkohë që dilni mbrapsht nga një hapësirë pingule parkimi. Nëse diktohet një automjet në lëvizje ose ndonjë rrezik tjetër, sistemi do t'ju sinjalizojë me paralajmërime vizuale dhe akustike. (Opsion)



Live Traffic*

Ju jep informacione të përditësuara për trafikun, si shpejtësinë e trafikut, aksidentet dhe bllokimet e rrugëve, si dhe udhëzime për itinerare alternative dhe harta për t'ju ndihmuar të shmangni zonat problematike. Disponohet me "FordPass Connect" nëpërmjet "SYNC 3" me navigim. (Opsion)



Sistem informimi për pikat e vdekura të shikimit me lidhjen e rimorkios⁽²⁾

Ndërsa një automjet tjetër – një makinë, furgon ose kamion – futet në pikën tuaj të vdekur të shikimit, sistemi është projektuar që t'ju sinjalizojë me një dritë paralajmëruese të integruar në pasqyrën e derës së shoferit dhe të pasagjerit. Nëse automjeti juaj ka një çengel rimorkimi të montuar në fabrikë dhe po tërheq një rimorkio, sistemi e zgjeron mbulimin që të përfshijë edhe rimorkion e tërhequr. (Opsion)

⁽²⁾Përdor sensorë. ⁽³⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.

Vini re Veçoritë e ndihmës për drejtuesin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e drejtuesit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin.

*Aksesi në "Live Traffic" është falas për 12 muaj pas regjistrimit të një "Ford" të ri me navigim SYNC 3; më pas paguhet një tarifë abonimi.


Shikojeni rrugën në një dritë të re

Ndriçim i përmirësuar për shikueshmëri të jashtëzakonshme.

Fenerët elegantë i japin "Tourneo Custom" një identitet të fortë. Të gjitha versionet përfshijnë drita për ditën, ndërsa fenerët e fuqishëm bixenon (standard në "Titanium X", opion në "Trend", "Titanium" dhe "Sport") ofrojnë ndriçim efektiv në të gjitha kushtet.

Drita të gjata automatike⁰²⁾

Kalojnë përkohësisht në drita të shkurtra kur diktohet trafik ose një automjet përpara dhe kthehen automatikisht në drita të gjata për shikueshmëri maksimale. (Standard në "Sport", opion si pjesë e paketës për të gjitha seritë e tjera)



Fenerë të stilit projektor me drita statike për kthesa

Kur e ktheni timonin më shumë se 30 gradë, dritat për kthesa ndriçojnë anën e duhur të rrugës për më shumë shikueshmëri natën. Funkcionon në shpejtësi deri në 30 km/orë. (Standard)

⁰Përdor sensorë. ²⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin.

Vini re Veçoritë e ndihmës për drejtuesin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e drejtuesit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin.

Fenerë bixenon me drita statike për kthesa

Fenerët bixenon të "Tourneo Custom" ofrojnë cilësi më të lartë ndriçimi në krahasim me llambat halogjene, ndërkohë që përdorin më pak energji. Dritat statike për kthesa të montuara brenda çdo feneri ndriçojnë qoshet gjatë kthesave në shpejtësi deri në 60 km/orë. Fenerët automatikë ndizen për të mbajtur rrugën përpara të ndriçuar mirë kurdo që e diktojnë nivelet e dritës së jashtme. (Standard në modelin "Titanium X", opion në modelet "Trend", "Titanium", "Active" dhe "Sport")



Tregohet "Tourneo Custom Titanium L1" me disqe aliazhi 17" 10-shkallëshe në "Dark Tarnish" (opion), në ngjyrë trupi "Moondust Silver" (opion).

Efikasiteti

"Tourneo Custom" fuqizohet nga një gamë motorësh me naftë "Ford EcoBlue" dhe "EcoBlue Hybrid" me performancë të lartë. Të gjitha versionet pajtohen me standardet më të fundit për emetimet dhe kombinojnë kostot e ulëta të përdorimit me forcën e dobishme të rrotullimit për performancë të cilës mund t'i besoni. Të fuqishëm, të pastër dhe të rafinuar, motorët me naftë "Ford EcoBlue" janë ndërtuar bazuar në performancën dhe teknologjinë lider në industri të motorëve tanë me benzinë "Ford EcoBoost" fitues të çmimeve.

Tek teknologjitë kryesore përfshihen


- Sistemi "Auto-Start-Stop" i "Ford"
- Ngarkimi rigjenerues inteligjent i "Ford"
- Llamba treguese e marshit – për të ndihmuar drejtimin ekonomik
- Kontrolli i përshpejtit – kalibrimi unik i motorit ndihmon në reduktimin e konsumit të karburantit kur automjeti drejtohet pa ngarkesë (opsion)
- Sistemi i menaxhimit të baterisë i "Ford" – rrit jetëgjatësinë e baterisë, përmirëson konsumin e karburantit dhe garanton qëndrueshmëri në nisje
- Sistemi i reduktimit katalitik selektiv (SCR) – përdor AdBlue® për t'i kthyer në azot dhe ujë emetimet e NO_x në gazin e shkarkuar
- Sistemi i furnizimit pa kapak "Ford Easy Fuel" ju ndihmon të shmangni mbushjen aksidentale me karburantin e gabuar



Teknologjia "Ford EcoBlue Hybrid"

"Tourneo Custom" disponohet me teknologjinë novatore të motorëve me naftë gjysmëhibridë. Një motorino/gjenerator i integruar rikuperon energjinë kur automjeti lëviz me inerci dhe e ruan në një bateri 48-voltëshe me jone litiumi. Energjia e ruajtur përdoret më pas për të ndihmuar motorin gjatë drejtimit dhe përshpejtit, si dhe për të fuqizuar pajisjet elektrike ndihmëse të automjetit. Sistemi rrit më tej kursimin e karburantit, sidomos gjatë drejtimit me ndalesa. (Opsion me transmisionin manual)


*Të dhëna zyrtare të certifikuara nga NEDC CO₂mPas. Shihni seksionin "Karburanti dhe CO₂" për më shumë informacion.



Ford EcoBlue 2.0L 130 PS

Motori me naftë "Ford EcoBlue" 130 PS (96 kW)/360 Nm arrin ekuilibrim të rendimentit, duke ofruar më tepër fuqi dhe forcë rrotullimi pa cenuar emetimet.


*Rezultatet e llogaritura të testit "WLTP" për ciklin e drejtimit. Për më shumë informacion, shihni seksionin "Karburanti dhe performanca".



Ford EcoBlue 2.0L 150 PS

"Ford EcoBlue" 150 PS (110 kW) jep forcë rrotullimi 360 Nm. Kjo e bën atë zgjedhjen ideale për zhvendosjen e ngarkesave të rënda dhe për rimorkim, duke arritur njëkohësisht efikasitet karburanti.

*Rezultatet e llogaritura të testit "WLTP" për ciklin e drejtimit. Për më shumë informacion, shihni seksionin "Karburanti dhe performanca".



Ford EcoBlue 2.0L 170 PS

Motori i avancuar me naftë i gjeneratës së re 2.0L "EcoBlue" i "Transit Custom" tani ofrohet në një variant më të fuqishëm 170 PS (125 kW). Duke ofruar një forcë mbresëlënëse rrotullimi prej 390 Nm, ai është motori më i fuqishëm në këtë gamë.

*Rezultatet e llogaritura të testit "WLTP" për ciklin e drejtimit. Për më shumë informacion, shihni seksionin "Karburanti dhe performanca".



Teknologji që ju lehtëson jetën

"Tourneo Custom" disponohet me një gamë veçorish sigurie dhe ndihme për shoferin për t'ju bërë drejtimin më të lehtë çdo herë.

Ndihmë aktive e parkimit^o

Kur janë të aktivizuar, sensorët mund të identifikojnë një hapësirë parkimi me përmasat e duhura dhe ju drejtojnë automatikisht brenda ose jashtë vendparkimit, ndërsa ju kontrolloni pedalet dhe marshet. Ndihe për daljen nga parkimi funksionon si ndihma aktive e parkimit në rend të kundërt, duke ju ndihmuar të dilni nga një hapësirë paralele. (Opsion)

Kontroll i qëndrueshmërisë në rrokullisje^{o1)}

Sensori unik i shpejtësisë këndore i "Ford" ndihmon sistemin e kontrollit të qëndrueshmërisë në rrokullisje t'i mbajë gomat në vend në kushte me qendër të lartë graviteti dhe gjatë drejtimit në kthesa në të tatëpjetë. (Standard)

Auto-Start-Stop

Ndihmon në maksimizimin e efikasitetit të karburantit. (Standard)

Kontroll i drejtimit shpërndarjes së forcës së rrotullimit^o

Projektuar për të përmirësuar tërheqjen, kapjen e rrotave në rrugë dhe shkathtësinë në kthesa, duke optimizuar vazhdimisht forcën e rrotullimit të motorit të shpërndarë në secilën rrotë të përparme për t'iu përshtatur forcës së kapjes që ka secila. (Standard)

Kontroll i fërkimit¹⁾

Nëse diktohet rrëshqitje e rrotave në shpejtësi të ulët, ky sistem mund të shpërndajë më shumë forcë rrotullimi te rrotat me fërkim më të madh. (Standard)

Ndihmë e frenave të emergjencës^{o1)}

Projektuar për të njohur një situatë frenimi emergjent dhe për të rritur presionin brenda sistemit të frenimit për të ofruar fuqi më të madhe ndalimi. (Standard)

Kontroll elektronik i stabilitetit (ESC)^{o1)}

Projektuar për t'ju ndihmuar të ruani kontrollin në kushte ekstreme drejtimi. Ai dikton kur devijoni nga rruga e zgjedhur dhe përpiqet t'ju mbajë në korsi duke rregulluar automatikisht frenimin dhe rendimentin e motorit. (Standard)

Aftësi mahnitëse rimorkimi

Me kapacitet maksimal rimorkimi deri në 2350 kg*, "Tourneo Custom" ofron fuqi mahnitëse rimorkimi, së bashku me një gamë veçorish sigurie për t'ju mbajtur juve dhe rimorkion të sigurt. (Përdoruesve tregtarë mund t'u nevojitet një takograf dixhital. Kapaciteti maksimal i rimorkimit ndryshon në bazë të ngarkesës, konfigurimit të automjetit, pjesëve shtesë dhe numrit të pasagjerëve)

Kontroll i lëkundjes së rimorkios^{o1)}

Projektuar për të diktuar kur ndodh lëkundje e rimorkios dhe për ta balancuar rimorkion në mënyrë që ta sjellë nën kontroll. (Standard, por aktivizohet me shtojcën opsionale të lidhjes së rimorkios së "Ford")

Ndihmë e nisjes në të përpjetë^{o2)}

Projektuar për të parandaluar përkohësisht rrokullisjen në pjerrësi kur e lëvizni këmbën nga pedali i frenave te pedali i gazit. Funksionon në marshet përpara dhe pas, pra është ideale për rimorkim dhe tërheqjen e ngarkesave të rënda. (Standard)

Airbagët

Airbag-u për shoferin, airbag-u për pasagjerin përpara^o, airbag-ët anësorë për gjoksin në sediljen përpara dhe airbag-ët anësorë në formë perdeshe janë vendosur si standard.

Xham i përparmë me ngrohje "Quickclear"

Mund të ndihmojë në heqjen shpejt të avullit nga xhami i përparmë, edhe në mëngjese me ngricë. (Standard)



^oPërdor sensorë. ¹⁾Veçoria e sigurisë. ²⁾Veçoria e ndihmës për drejtuesin. **Vini re** Veçoritë e ndihmës për drejtuesin janë funksione shtesë dhe nuk zëvendësojnë vëmendjen e drejtuesit, gjykimin e tij dhe nevojën për të kontrolluar automjetin.

*Kapaciteti maksimal i rimorkimit në serinë L2.

***Vini re: Një sedilje fëmije që sheh nga pas nuk duhet vendosur kurrë në sediljen e pasagjerit përpara kur automjeti "Ford" është i pajisur me airbag funksional për pasagjerin përpara. Vendi më i sigurt për fëmijën është kufizimi i saktë në sediljet e rreshtit të dytë.**

FORD TOURNEO CUSTOM Dizajn inteligjent



Inxhinieri më inteligjente për nivel më të lartë qetësie


Me 4500 testime përplasjesh në emrin e tij - si në botën virtuale ashtu edhe në atë reale - "Tourneo Custom" është projektuar për t'i mbajtur pasagjerët sa më të sigurt që është e mundur. Mbrojtja e shkëlqyer fillon nga struktura solide e trupit, me nivele më të larta çeliku me rezistencë të lartë dhe rezistencë ultra të lartë. Dhe plotësohet nga një gamë inovacionesh, duke përfshirë një gamë të plotë airbagësh, plus teknologjinë e avancuar të shasisë dhe të frenimit.

Airbagët për gjoksin dhe në formë perdesh

Projektuar për të ndihmuar në mbrojtjen e kokës së shoferit dhe të pasagjerëve përpara nga lëndimi. (Standard)

Fuqi ndalimi

"Tourneo Custom" e ka prioritet kryesor mbrojtjen e shoferit dhe të pasagjerëve. Karakteristikat standarde të sigurisë përfshijnë një sistem të plotë "ESC" me "ABS" dhe ndihmë të frenave të emergjencës (EBA) për të ndihmuar në reduktimin e distancave të ndalimit urgjent. Pedalet më të mëdha të frenave zgjasin më shumë dhe janë më rezistente ndaj dobësimit të frenave, ndërkohë që sensorët e konsumimit tregojnë se kur duhen ndërruar pedalet.



Drejtimi me "AdBlue®"

Për të funksionuar siç duhet, depozita "AdBlue®" e motorit me naftë të "Ford Tourneo Custom" në përputhje me "Euro6" duhet të mbushet me lëng "AdBlue®". Dritat paralajmëruese të sistemit ndriçojnë kur niveli i lëngut ulet shumë. Për më shumë informacion, kontaktoni shitësin e "Ford".

Ajër i kondicionuar në pjesën e pasagjerëve prapa

Disponohet një sistem i veçantë kondicionimi për hapësirën e pasagjerëve prapa, me komanda individuale rrotullimi. (Standard në "Titanium", "Titanium X" dhe "Sport", opsion në "Trend")



Modelet "Trend"

Karakteristikat e jashtme kryesore

- Disqe aliazhi 16" 5x2-shkallëshe
- Fenerë të stilit projektor me drita statike për kthesa, drita "LED" për ditën dhe fikje të vonuar
- Drita të përparme kundër mjegullës me ndriçim të përshtatshëm në kthesa
- Mbyllje qendrore nga distanca me dy çelësa elektronike
- Sensorë për distancën e parkimit, përpara dhe prapa
- Mbrojtëse të përparme dhe të pasme kundër baltës

Veçoritë kryesore të pjesës së brendshme

- Radio FM me "DAB", "Ford SYNC" me Bluetooth®, ekran TFT 4", komanda të audios në distancë, panel kontrolli të integruar, modem "FordPass Connect", portë lidhjeje USB me funksionalitet iPod® dhe dhjetë altoparlantë
- Sedilje universale në stil salle konferencash me sedilje individuale në rreshtin e dytë, të cilat mund të rrotullohen, si dhe sedilje 2+1 në rreshtin e tretë. Të gjitha sediljet mund të palosen, ulen, fshihen ose hiqen
- Kondicioner përpara me filtër poleni
- Timon me zbukurime Sensico®
- Kontroll drejtimi me kufizues shpejtësie me përshtatje
- Mbulesë dyshemeje me tapet në hapësirën e pasagjerëve dhe bagazheve
- Dritare të përparme elektrike, me ulje/ngritje me një të prekur në anën e shoferit
- Airbag për shoferin, airbag për pasagjerin përpara®, airbag-ë anësorë për gjoksin në sediljen përpara dhe airbag-ë anësorë në formë perdes

Paketat e disponueshme të opsioneve:

Paketa e shikueshmërisë - E ulët

- Pasqyra dyerësh elektrike dhe me ngrohje, me



sinjale anësore dhe veçorinë e palosjes automatike

- Xhami i përparmë me ngrohje "Quickclear"
- Sensor i nivelit të ulët të lëngut larës

